

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ferit Osmani, kryetar i kolegjit, gjyqtarët Hashim Çollaku dhe Biljana Rexhiq, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Hysni Ismaili, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit, B.H., nga Kamenica, për shkak të veprës penale vjedhje e rëndë nga neni 327 par. 1 nën par 1.1 të KPK, duke vendosur sipas ankesës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan-dega në Kamenicë, P.nr.182/2013, të datës 22.12.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur me 27.02.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Me aprovimin e ankesës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, **ndryshohet** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan-dega në Kamenicë, P.nr.182/2013, të datës 22.12.2016, përkitazi për vendimin për dënimin, ashtu që kolegji i kësaj gjykate të akuzuarit B.H., për shkak të veprës penale vjedhje e rëndë nga neni 327 par 1 nën par 1.1 të KPK, i shqipton dënimin me kusht, duke i vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet, po që se i akuzuari në afatin e verifikimit prej 2 (dy) viteve, nuk kryen ndonjë vepër të re penale.

Mbikëqyrjen dhe zbatimin e dënimit me kusht, në kuptim të nenit 150 par 1 të Ligjit mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, do ta bëjë Shërbimi Sprovues në Gjilan.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës Themelore në Gjilan-dega në Kamenicë, P.nr.182/2013, të datës 22.12.2016, është shpallur fajtor i akuzuari, B.H., për shkak të veprës penale vjedhje e rëndë nga neni 327 par 1 nën par 1.1 të KPK, dhe i është shqiptuar dënimi me kusht, duke i vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet, po që se i akuzuari në afatin e verifikimit prej 1 (një) viti, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nuk kryen ndonjë vepër të re penale.

Është obliguar i akuzuari që ti paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës penale sado që të jenë ato sipas llogarisë së bërë në anë të gjykatës, si dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 20 (njëzetë) €, të gjitha këto në afatin prej 30 (tridhjetë) ditëve, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Kundër këtij aktgjykimi, në afat ligjor ka ushtruar ankesë Prokuroria Themelore në Gjilan, për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, duke propozuar që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet, dhe të akuzuarit ti shqiptohet dënimi me burgim më i ashpër.

Prokuroria e Apelit në Prishtinë me shkresën PPA/II.nr.150/2017, të datës 03.02.2017, duke u sqaruar përkitazi me ankesën e Prokurorisë Themelore në Gjilan, ka propozuar që e njëjta të aprovohet si e bazuar, kurse aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të akuzuarit ti shqiptohet dënimi me burgim më i ashpër.

Gjykata e Apelit në kuptim të nenit 394 të KPPK, duke vlerësuar pretendimet ankimore nga ankesa e prokurorisë, propozimit me shkrim të Prokurorisë së Apelit në Prishtinë, si dhe shkresave tjera të lëndës ka gjetur se:

Ankesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan, është e bazuar.

Me qenë se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, gjykata duke vepruar në pajtim me nenin 394 të KPPK, e shqyrtoj aktgjykimin e ankimuar nëse i njëjti është marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe gjeti se i njëjti nuk përmban shkelje të dispozitave të procedurës, të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij, si dhe shkeljet e ligjit penal në dëm të akuzuarit, për të cilat kjo gjykatë kujdeset kryesisht sipas detyrës zyrtare.

Sipas ankesës së prokurorisë, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është ankimuar për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, duke theksuar se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike, se i akuzuari ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë, duke i vërtetuar elementet objektive dhe subjektive të veprës penale, dhe se i njëjti e ka pranuar fajësinë për veprën penale vjedhje e rëndë nga neni 327 par 1 nën par 1.1 të KPK, mirëpo për kundër fakteve dhe provave të administruara në procedurë, gjykata e shkallës së parë të akuzuarit nuk i ka shqiptuar dënimin përkatës ligjor, sepse këtë dënim e ka zbutur deri në atë masë sa që bie në kundërshtim me rregullat e përgjithshme për matjen dhe zbutjen e dënimit nga nenet 74, 75, 76 të KPK. Gjykata e shkallës së parë me rastin e marrjes së vendimit për dënimin, llojit dhe lartësisë së tij, nuk i ka vlerësuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë rrethanat lehtësuese apo rënduese, të cilat ndikojnë në marrjen e vendimit për dënimin, ngase rrethanat lehtësuese çfarëdo qofshin ato nuk kanë guxuar që të ndikojnë deri në atë masë që të akuzuarit ti shqiptohet një dënim aq i butë. Gjithashtu gjykata se shkallës së parë me rastin e marrjes së vendimit për dënimin, llojit dhe lartësisë së tij, ka vlerësuar vetëm rrethanat lehtësuese, ndërsa nuk i ka vlerësuar rrethanat rënduese sikurse janë shkalla e përgjegjësisë penale të akuzuarit, se vepra penale është kryer me dashje dhe vetëdije të plotë, si dhe dëmin e shkaktuar të dëmtuarit, andaj, konsiderojmë se dënimi i shqiptuar nuk është në proporcion me peshën e veprës penale të kryer, rrezikshmërinë shoqërore të saj, si dhe përgjegjësinë penale të akuzuarit, dhe se me dënime të tilla nuk do të mund të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit i paraparë me ligj.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, ankesën e ushtruar nga prokuroria, si dhe shkresat e tjera të lëndës, dhe ka ardhur në përfundim, se nga ana e gjykatës së shkallës së parë, në mënyrë të drejtë dhe të plotë është

vërtetuar gjendja faktike, se gjykata e shkallës së parë, ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë me rastin e marrjes së vendimit për dënimin, caktimit të llojit dhe lartësisë së tij, në kuptim të nenit 73 të KPK, sikurse janë rrethanat lehtësuese, se i akuzuari e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, se ka patur sjellje korrekte në gjykatë, se është penduar thellë për veprën penale të kryer, se me të dëmtuarin ka raporte të mira dhe më asnjëherë tjetër nuk ka pasur probleme tjera, se të dëmtuarit i ka kërkuar falje publike, se është hera e parë që ka rënë në kundërshtim me ligjin, se ndaj tij nuk zhvillohet procedurë tjetër penale, se i akuzuari i ka premtuar gjykatës se nuk do të kryejë vepra penale në të ardhmen, ndërsa rrethana rënduese nuk gjeti, mirëpo kolegji i kësaj gjykate, pas vlerësimit të ankesës së prokurorisë, aktgjykimit të ankimuar si dhe shkresave të tjera të lëndës, ka ardhur në përfundim se gjykata e shkallës së parë, me dënimin e shqiptuar sa i përket afatit të verifikimit, me të njëjtin nuk mund të pritët që të ndikohet pozitivisht në të akuzuarin që në të ardhmen mos të kryejë ndonjë vepër të re penale, duke e pasur parasysh dispozitën ligjore nga neni 74, 75 dhe 76 të KPK, sa i përket rregullave të përgjithshme për zbutjen ose ashpërsimin e dënimeve, zbutjen e dënimeve si dhe kufijtë e zbutjes së dënimeve, të cilat i ka aplikuar në mënyrë të drejtë, mirëpo sa i përket dënimit me kusht të shqiptuar si dhe afatit të verifikimit, e sidomos duke patur parasysh mënyrën e kryerjes së veprës penale si dhe natyrën e së njëjtës, kolegji i kësaj gjykate vlerëson që aktgjykimi i ankimuar duhet të ndryshohet sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kolegji i kësaj gjykate është i bindur se me dënimin e shqiptuar do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij i paraparë me nenin 41 të KPK, që të parandaloj kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëj rehabilitimin e tij, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëj kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale, dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Mbikëqyrjen dhe zbatimin e dënimit me kusht, në kuptim të nenit 150 par 1 të Ligjit mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale të Republikës së Kosovës, do ta bëjë Shërbimi Sprovues në Gjilan.

Nga sa u tha më lartë e në pajtim me dispozitën e nenit 403 të KPPK, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PA1. nr.127/2017 të datës 27.02.2017

Bashkëpunëtori profesional
Hysni Ismaili

Anëtarët e kolegjit
Hashim Çollaku

Kryetari i kolegjit
Ferit Osmani

Biljana Rexhiq